STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE UDHETAREVE TE GADISHULLIT TE ROKEUEJ (ROCKAWAY) U AKORDOHEN NDRYSHIME TE PERKOHESHME PER TE LEHTESUAR TRANSFERIMET

Periudha e transferimit zgjatet deri në 3 orë në disa raste

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se në mënyrë që të bëhet udhëtimi më i lehtë për udhëtarët ndërmjet Kuins (Queens) "toka" dhe Gadishullit të Rokëuej (Rockaway), Ndërmarrja e Autobusave MTA (MTA Bus Company), Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit) dhe Ekspresi Ndërmjet Qarqeve i Nasos (Nassau Inter-County Express) (NICE) kanë bërë ndryshimet e nevojshme të programit kompjuterik për të lejuar transferimet me tre pjesë (një tarifë) dhe periudha transferimi prej tre orësh ndërmjet disa autobusave dhe metrove.

Që kur super stuhia Sendi (Sandy) shkatërroi lidhjen e linjës A me Gadishullin Rokëuej (Rockaway), MTA ka siguruar autobusa për transport falas ndërmjet stacionit A të Hauard Biç (Howard Beach A) dhe stacionit A të Far Rokëuej (Far Rockaway-Mott Avenue A). Përveç kësaj, një shërbim falas i transportit me trenin H u vendos ndërmjet stacioneve të Far Rokëuej (Far Rockaway-Mott Avenue) dhe Beach 90th Street.
Pavarësisht nga këto dy shërbime falas, shumë udhëtarë e gjetën veten duke paguar dy tarifa sepse kur vinte koha që një udhëtar i metrosë të hipte në një autobus të gadishullit, kishte kaluar me shumë sesa afërsisht dy orë të periudhës së transferimit.

"Gadishulli i Rokëuej ishte mes rajoneve të goditura më rëndë në rajon dhe e dimë se nuk do të jetë në gjendje normale si zakonisht për disa kohë. Shpresojmë se ndryshimi përkohësisht i praktikës së transferimeve do t'a bëjë më të lehtë që të udhëtohet dhe do t'a bëjë udhëtimin më të leverdisshëm për udhëtarët," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo).

Duke filluar këtë javë, periudha e transferimit për transferimet nga çdo stacion i metrosë në drejtimet e autobusave Q22, Q113, N31, N32 dhe N33 është zgjatur në tre orë. Gjithashtu, transferimet me tre pjesë (një tarifë) lejohen tani në udhëtimet e mëposhtme në të dyja drejtimet:

- Stacioni Flatbush Avenue-Brooklyn college 2,5/deri në Q35/deri në Q22
- Stacioni Rockaway Boulevard A/deri në Q52 ose Q53/deri në Q22

Këto ndryshime do të mbeten në fuqi derisa të rivendoset shërbimi normal A në Rokëuejs (Rockaways), që tani vlerësohet të jetë një periudhë e gjatë kohe.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian